







Garë ndërkombëtare KENGUR 16.03.2017**Klasa e 8 dhe 9 -Kategorija Kadet**

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 30 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 150. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët

Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 10 vlerësohet me 3 pikë

- Sa do të jetë ora 17 orë pas orës 17:00?
(A) 8:00 (B) 10:00 (C) 11:00 (D) 12:00 (E) 13:00
- Një grup vajzash qendrojnë në formë rethi. Florija është e katërta nga e majta e Teutës dhe e shtata nga e djathta e Teutës. Sa vajza janë në grup?
(A) 9 (B) 10 (C) 11 (D) 12 (E) 13
- Cili numër duhet të zbritet nga -17 që të fitohet numuri -33 ?
(A) -50 (B) -16 (C) 16 (D) 40 (E) 50
- Në figurën djathtas është paraqitur një trekëndësh barakrahës me lartësinë e tij i mbushur me shirita. Çdo shirit ka lartësi të njëjtë. Cila pjesë e suprinës së trekëndëshit ze pjesa e bardhë?
(A) $\frac{1}{2}$ (B) $\frac{1}{3}$ (C) $\frac{2}{3}$
(D) $\frac{3}{4}$ (E) $\frac{2}{5}$
- Cili nga barazimet e mëposhtme është i saktë?
(A) $\frac{4}{1} = 1,4$ (B) $\frac{5}{2} = 2,5$ (C) $\frac{6}{3} = 3,6$ (D) $\frac{7}{4} = 4,7$ (E) $\frac{8}{5} = 5,8$
- Në figurë janë paraqitur dy drejtkëndësha të cilat kanë brinjë paralele. Cila është diferenca e perimetreve të këtyre dy drejtkëndëshve?
(A) 12 m (B) 16 m (C) 20 m
(D) 21 m (E) 24 m
- Ana palosi një copë letreje dy herë, më pas në letrën e palosur shpoi një vrimë. Kur e shpalosi letrën ajo kishte pamjen si në figurën djathtas. Si e palosi Ana copën e letrës?



8. Shuma e tre numrave natyrorë të ndryshëm është 7. Sa është prodhimi i atyre numrave?
 (A) 12 (B) 10 (C) 9 (D) 8 (E) 5


9. Në vizatimin djathtas janë paraqitur katër zemra të cilat pudhithen. Suprinat e zemrave janë përkatësisht 1 cm^2 , 4 cm^2 , 9 cm^2 dhe 16 cm^2 . Sa është suprina e pjesës së hijëzuar?
 (A) 9 cm^2 (B) 10 cm^2 (C) 11 cm^2
 (D) 12 cm^2 (E) 13 cm^2




10. Florija ka 20 denarë. Secila prej katër motrave të saj ka nga 10 denarë. Sa denarë Florija duhet ti japë secilës prej motrave të saj në mënyrë të tillë që të pesë motrat të kenë të njëjtën shumë denarësh?
 (A) 2 (B) 4 (C) 5 (D) 8 (E) 10

Cdo detyrë me numër rendor nga 11 deri 20 vlerësohet me 4 pikë

11. Milingona Eni filloi të lëvizë nga ana e majtë e shinës dhe kaloi $\frac{2}{3}$ nga gjatësija e saj. Nuselalja Buba filloi të lëvizë nga ana e djathtë e shinës dhe kaloi $\frac{3}{4}$ nga gjatësija e saj. Sa është gjatësija e shinës midis Enit dhe Bubës?



- (A) $\frac{3}{8}$ (B) $\frac{1}{12}$ (C) $\frac{5}{7}$ (D) $\frac{1}{2}$ (E) $\frac{5}{12}$
12. Një e gjashta e publikut të teatrit të fëmijëve janë të ritur. Dy të pestët e fëmijëve janë djem. Sa pjesë e publikut janë vajza?
 (A) $\frac{1}{2}$ (B) $\frac{1}{3}$ (C) $\frac{1}{4}$ (D) $\frac{1}{5}$ (E) $\frac{2}{5}$
13. Në figurë linja e ndërprerë dhe ajo e pandërprerë formojnë shtatë trekëndësha barabrinjës. Gjatësija e linjës së ndërprerë është 20. Sa është gjatësija e linjës së pandërprerë?
 (A) 25 (B) 30 (C) 35 (D) 40 (E) 45



14. Katër kusherira Ema, Mira, Renata dhe Teuta kanë 3, 8, 12 dhe 14 vjeç, por vitet e tyre mund të mos i korespondojnë radhitjes së emrave. Ema është më e re sesa Renata. Shuma e viteve të Teutës dhe Emës plotpjestohet me 5. Po kështu shuma e viteve të Teutës dhe Renatës plotpjestohet me 5. Sa vite ka Mira?
 (A) 14 (B) 12 (C) 8 (D) 5 (E) 3
15. Këtë vit në maratonën e Shkupit morën pjesë më shumë se 800 maratonistë. Saktësisht 35% nga maratonistët ishin femra dhe kishte 252 më shumë meshkuj sesa femra. Sa meshkuj kishte në garë?
 (A) 802 (B) 810 (C) 822 (D) 824 (E) 840

16. Florija duhet të shënojë nga një numur në çdo kuti të figurës djathtas. Ajo shënoi dy prej numrave. Florija do që shuma e numrave të shënuar në kutitë të jetë 35, shuma e numrave të shënuar në tre kutitë e para të jetë 22, ndërsa shuma e numrave të shënuar në tre kutitë e fundit të jetë 25. Sa është prodhimi i numrave të cilat Florija duhet ti shënojë në kutitë të hijëzuara?




(A) 63 (B) 108 (C) 0 (D) 48 (E) 39

17. Sara do që të presë një pe në nëntë pjesë me të njejtat gjatësi, prandaj i shënon pikat ku duhet të presë. Meri do ta presë të njejtin pe në tetë pjesë të njejtë, prandaj i shënon pikat ku duhet të presë. Në fund Miri e mori perin dhe e preu në të gjithë pikat e shënuara. Sa pjesë peri i dolën Miri?

(A) 15 (B) 16 (C) 17 (D) 18 (E) 19

18. Dy segmente secila me gjatësi 1 cm, janë përcaktuar në brinjët e kundërta të katrorit brinja e të cilit ka gjatësi 8 cm. Skajet e segmenteve janë lidhur si në figurë djathtas. Sa është suprina e shprehur në cm^2 e pjesës së katrorit të hijëzuar?

(A) 2 (B) 4 (C) 6.4 (D) 8 (E) 10



19. Todi do që të bëjë orar javor për vrapim. Ai do që të vrapojë dy herë në javë dhe vrapimet të jenë në të njejtat ditë të javës. Todi nuk do që të vrapojë në dy ditë të njëpasnjëshme. Sa orare të ndryshme mund të bëjë Todi?

(A) 16 (B) 14 (C) 12 (D) 10 (E) 8

20. Sara do që të shënojë numra në çdo kuti të tabelës me përmasa 3×3 në mënyrë të tillë që shuma e numrave në çdo dy kuti të cilat kanë brinjë të përbashkët të jetë i njëjtë. Ajo ka shënuar dy numra si në figurë. Cila është shuma e të gjithë numrave në tabelë?

(A) 18 (B) 20 (C) 21 (D) 22 (E) 23

2		
		3

Cdo detyrë me numër rendor nga 21 deri 30 vlerësohet me 5 pikë

21. Madhësia e këndeve e shprehur në shkallë në një trekëndësh janë tre numra të ndryshëm natyrorë. Cila është shuma e mundëshme minimale e këndit më të vogël dhe më të madh të trekëndëshit?

(A) 61° (B) 90° (C) 91° (D) 120° (E) 121°

22. Dhjetë kengurë janë rradhitur si në figurë. Në një moment dy kengurë të cilët janë njëri pas tjetrit dhe të kthyer njëri përballë tjetrit i këmbëjnë vendet duke kapërcyer njëri-tjetrin. Kjo përsëritet deri sa këto kërcime janë të mundshme. Sa kërcime janë kryer?



(A) 15 (B) 16 (C) 18 (D) 20 (E) 21

23. Dijana ka nëntë numra : 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. Ajo i shton 2 disave prej tyre dhe 5 numrave të mbetur. Cili është numri më i vogël i rezultateve të ndryshme që ajo mund ti fitojë?

(A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9

24. Në çdo tre minuta autobuzi shkon nga aerodromi në qendër të qytetit. Vetura niset nga aerodromi në të njëjtën kohë si një autobus dhe deri në qendrën e qytetit kalon të njëjtën rrugë si autobuzat. Nga aerodromi deri në qendër autobuzat e bëjnë 60 minuta, ndërsa veturat për 35 minuta. Sa autobuzë takoi vetura duke shkuar për në qendër duke mos llogaritur autobuzin me të cilin u nisën bashkë?

(A) 8 (B) 9 (C) 10 (D) 11 (E) 13

25. Tavalina e përkryer e Dijanës duket si në vizatimin djathtas. Sa përqind e tavolinës është njirosur me bojë të zezë?

(A) 16 (B) 24 (C) 25 (D) 32 (E) 36




26. Çdo shifër e vargut që fillon me shifrat 2, 3, 6, 8, 8 është formuar në këtë mënyrë: dy shifrat e para janë 2 dhe 3 dhe pastaj çdo shifër është shifra e njesheve të prodhimit të dy shifrave të mëparshme të vargut. Cila është shifra e 2017-të në varg?

(A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 6 (E) 8

27. Miri ka 125 kube të vegjël. Ai ngjiti disa prej tyre dhe formoi një kub të madh me nëntë tylene të cilat kalojnë në të gjithë kubin siç është treguar në figurë. Sa kube të vegjël nuk përdori Miri?

(A) 52 (B) 45 (C) 42 (D) 39 (E) 36




28. Dy atletë vrapojnë në një pistë rrethore me gjatësi 720 metra. Atletët vrapojnë në drejtime të kundërta me shpejtësi konstante. Që të rrotullohet një herë pista atletit të parë i duhen katër minuta, ndërsa atletit të dytë i duhen pesë minuta. Sa metra do të vrapojë atleti i dytë midis takimeve të njëpasnjeshme me atletin e parë?

(A) 355 (B) 350 (C) 340 (D) 330 (E) 320

29. Sara do të shënojë nga një numur natyror në çdo kuti të vizatimit djathtas në mënyrë të tillë që çdo numur sipër rjeshtit të poshtëm është shumë e dy numrave në kutitë njiutur sipër tij. Cili është numri më i madh i numrave tek të cilat Sara mund ti shënojë?

(A) 5 (B) 7 (C) 8 (D) 10 (E) 11



30. Në figurë është dhënë paralelogrami $ABCD$ me suprinë S . Pika prerëse e diagonaleve të tij është O . Në brinjën DC është marë pika M . Pika prerëse e AM dhe BD është E , pika prerëse e BM dhe AC është F . Shuma e suprinave të trekëndëshve AED dhe BFC është $\frac{1}{3}S$. Sa është suprina e katërkëndëshit $EOFM$, e shprehur nëpërmjet S ?

(A) $\frac{1}{6}S$ (B) $\frac{1}{8}S$ (C) $\frac{1}{10}S$ (D) $\frac{1}{12}S$ (E) $\frac{1}{14}S$

